



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 060-74376 dt. 21.12.2018



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Labinot Halila


Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 21.12.2018

1. Vendim për vazhdimin e dhënien në menaxhim-shfrytëzim të përkohshëm të Parkingut të automjeteve që gjendet në hapsirat e stacionit të autobusëve, Shoqatave të dalura nga Lufta
2. Vendim për inicimin e themelimit të teatrit amator të qytetit.
3. Vendim Për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e qendrës edukativo-kulturore, nga parcela 782-0 dhe pjesa e parcelës 768-1, në parcelen Nr.01001-3 në zonën kadastrale në Drenas



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Zyra Kryetarit



Nr. 01-060-74375 dt. 21.12 /2018

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. **Ramiz Lladrovci**

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 21.12.2018

1. Vendim për vazhdimin e dhënien në menaxhim-shfrytëzim të përkohshëm të Parkingut të automjeteve që gjendet në hapsirat e stacionit të autobusëve, Shoqatave të dalura nga Lufta
2. Vendim për inicimin e themelimit të teatrit amator të qytetit.
3. Vendim Për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e qendrës edukativo-kulturore, nga parcela 782-0 dhe pjesa e parcelës 768-1, në parcelen Nr.01001-3 në zonën kadastrale në Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-74377 dt 21.12 2018

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 si dhe nenit 40 i Ligjit nr 03/L-040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15, qershor 2008), të nenit 3, pika 1.3, neni 7, i Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.35/17 dhjetor 2012), si dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datën 21.12.2017 miratoi këtë:

VENDIM

Për vazhdimin e dhënien në menaxhim-shfrytëzim të përkohshëm të Parkingut të automjeteve që gjendet në hapsirat e stacionit të autobusëve, Shoqatave të dalura nga Lufta

- I. Parkingu për automjete, si pronë e paluajtshme komunale që do të jepet në shfrytëzim të përkohshëm, ka këto karakteristika: 1. Pjesët e parceles kadastrale nr.P - 70315016-00726-15, në vendin e quajtur "Arat e Ibrit", tek stacioni i autobusëve në Glllogoc
- II. Afati kohor për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm përshkruar në pikën I të këtij Vendimi, është në periudhë afatshkurtër për 1 vit.
- III. Parkingu i përshkruar në pikën 1 të këtij Vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- IV. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të parkingut do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës




Kryetari i Kuvendit të Komunës

Labir Hoti



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr 12-030-74387 dt. 21.12.2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 4 pika 3 të Ligjit për Teatrot nr. 04.L- 106, Rregullores nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 21.12.2018 aprovoj këtë:

VENDIM

Për iniciimin e themelimit të teatrit amator të qytetit

1. Inicohet procedura për themelimin e teatrit amator të qytetit si institucion me status publik.
2. Procedurat e themelimit të teatrit amator do të zhvillohen sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, përkatësisht pas vlerësimit profesional të Komisionit të veçantë të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës
5. Me këtë Vendim njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-354-74398 dt. 21.12 2018

Në bazë të nenit 11,12 dhe nenit 40 pika 40.2 nën I të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në bazë të nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës , dhe në bazë të Memorandumit të Bashkepunimit në mes të Komunes së Drenasit dhe Shoqatës Ekonomike Kulturore “Qëndresa Kosovare” SH.E.K.Q.K, organizatë jo-qeveritare me Nr.511402-7 të regjistrimit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 21.12.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e qendrës edukativo-kulturore, nga parcela 782-0 dhe pjesa e parcelës 768-1, në parcelen Nr.01001-3 në zonën kadastrale në Drenas

Neni 1

Më këtë Vendim ndryshohet lokacioni për ndërtimin e objektit edukativo-kulturor, donacion nga Shoqata Ekonomike Kulturore “Qëndresa Kosovare” në Prishtinë, nga parcela Nr. 782-0 dhe pjesa e parcelës 768-1 në zonën kadastrale në Drenas, në parcelen Nr.01001-3 po ashtu në zonene kadastrave në Drenas.

Neni 2

Shoqata Ekonomike Kulturore “Qëndresa Kosovare” në Prishtinë, sipas Memorandum Bashkëpunimit me Komunën e Drenasit, në parcelën Nr.01001-3, në zonën kadastrale në Drenas, do të ndërtoj në formë donacioni objektin edukativo-kulturor, pas përfundimit të objektit, i njëjti do të dorëzohet në menaxhim komunës së Drenasit.

Neni 3

Parcela nr.01001 në zonën kadastrale në Drenas, ka sipërfaqe prej $S = 0.13.15$ ha, dhe ndodhet në zonën kadastrale në Drenas, ndërsa objekti që do të ndërtohet në këto pjese të parceles kadastrale është në sipërfaqe prej; Përdhesa $189.5m^2$, Kati I $200.5m^2$.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit që të jap pëlqim për lokacionin e ndërtimit të objektit të cilin do ta ndërtoj SH.E.K.Q.K "Qëndresa Kosovare" në Prishtinë.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Drenasit që në bazë të këtij Vendimi të benë regjistrimin e objektit në emër të Komunës së Drenasit në librat kadastrale dhe në RDPP.

Neni 6

Pas hyrjen në fuqi të këtij vendimi,shfuqizohet vendimi Nr.12-400-57433 i dates 25.09.2018 i Kuvendit të komunës së Drenasit më të cilin vendim ishte miratuar lokacioni në parcelen Nr.782-0 dhe pjesen e parceles Nr.768-1,në zonen kadastrale në Drenas.

Neni 7

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
B. Labibol Halilaj

